



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.889/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada Glllogjani anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë në Kuvend Komunal në Ferizaj Besim Veliu nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare ne Mundemi, me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.889/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit Besim Veliu nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi, me seli në Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 kandidatit për anëtarë në Kuvend Komunal në Ferizaj Besim Veliu nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare ne Mundemi, me seli në Ferizaj në të cilën pretendon se ka fakte të se votat e ti janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi. Duke qenë e bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në Qendrat e Votimit 2531D/01R të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve te ti në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i tyre është dëmtuar. Si dëshmi apelit i ka bashkangjitur deklaratat e personave që e kanë votuar ndërsa në këto vendvotime i figurojnë 0 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit Besim Veliu nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare Ne Mundemi, me seli në Ferizaj, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 2531D/01R ne Ferizaj per shkak te dyshimit per manipulimit, pas kërkimeve te bëra rezulton se i njëjti ne kete vendvotim ka 3 vota po aq sa ka edhe deklarata.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.889/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.